

VENDIM
Nr. 47, datë 7.3.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
TË SHOQËRISË OSHEE SHA PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të neneve 16; 20, gjerat “a” dhe “e” dhe nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 9 dhe 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2018,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 808 prot., datë 15.1.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s Planin e Përditësuar të Investimeve për vitin 2018.

- Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2018, të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a., duke konstatuar se plani i investimeve për vitin 2018:

- Paraqitet i ndarë sipas kategorive dhe zërave të shoqëruar me vlerat përkatëse financiare, si dhe një relacion të përgjithshëm teknik për investimet që priten të realizohen gjatë vitit 2018.

- Përmirëson shërbimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes.

- Bazuar në relacionin e dërguar nga OSHEE sh.a. do të ketë impakt në uljen e humbjeve teknike edhe joteknike.

- Ndikon në mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuara dhe në Kodin e Shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Plotëson dhe përmirëson sistemin e matjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Parashikon periudha kohore të zbatimit të investimit për ndërtimet apo rehabilitimet e investimeve përkatëse.

- Mbetet problematik zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve, i cili duhet të shoqërohet me:

- informacion lidhur me kapitalizimin e investimeve të realizuara 2017;

- informacion të plotë lidhur me investimet e realizuara nëpërmjet partneritetit publik privat, kontratat dhe detyrim/realizimet;

- informacion mbi financimin dhe burimin e këtyre financimeve për realizimin e planit të investimeve për vitin 2018, si dhe periudhat e shlyerjes së këtyre investimeve;

- planifikimet e investimeve për të parandaluar problematikën e evidentuara, si në rastin e N/St Ballsh dhe prodhuesve të lidhur në N/St Lozhan;

- miratimin e Këshillit Mbikëqyrës për planin e investimeve për vitin 2018.

- Në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka detyrimin të miratojë planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, i cili përcillet në ERE për miratim, pas hartimit, nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2018.

2. OSHEE sh.a. të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas konstatimeve në këtë vendim.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi